

V E N D I M
Nr.263, datë 29.7.1999

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Nikoleta Kita	Anëtar
Vitore Tusha	“
Bashkim Caka	“
Tefta Zaka	“
Metush Saraçi	“
Artan Hoxha	“
Vladimir Metani	“
Vladimir Bineri	“
Vangjel Kosta	“
Zamir Poda	“
Natasha Sheshi	“
Ylvi Myrtja	“
Agron Lamaj	“

në seancën gjyqësore të datës 29.7.1999 mori në shqyrtim çështjen penale me nr.263 akti, që u përket të pandehurve Musa Protoduari, Fran Marashi, Sokol Ndreu etj.;

Me objekt: Njësimin e praktikës gjyqësore përse u përket kriterëve të transferimit të çështjeve penale nga një gjykatë e shkallës së parë në një gjykatë tjetër të shkallës së parë, si dhe lidhur me kompetencën tokësore të gjykimit (nenet 94 dhe 76 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë).

Në gjykatën e rrethit Tiranë është paraqitur për gjykim çështja penale me të pandehur Musa Protoduari, Fran Marashi, Sokol Ndreu etj., akuzuar sipas neneve 74/c, 333-25, 334-25, 80-25 etj. të Kodit Penal.

Në seancën e fillimit të gjykimit të kësaj çështjeje, datë 8.7.1999, prokurori ka kërkuar transferimin e gjykimit të çështjes nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, në gjykatën e rrethit gjyqësor të Beratit.

Gjykata e rrethit të Tiranës, duke e vlerësuar të legjitimuar këtë kërkesë për transferim të çështjes në gjykatën kompetente nga pikëpamja tokësore, ka marrë vendim të ndërmjetëm për t'ia dërguar atë së bashku me dosjen për shqyrtim Gjykatës së Lartë.

Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë të pandehurit Sokol Ndreu dhe Gjovalin Ndreu, të cilët e konsiderojnë vendimin e gjykatës së Rrethit të Tiranës të kundërligjshëm, sepse bie në kundërshtim me nenin 86, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale; si dhe me vendimin nr. 36, datë 2.4.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur një herë transferimin e kësaj çështjeje nga gjykata e rrethit të Beratit në gjykatën e rrethit të Tiranës.

Kryetari i Gjykatës së Lartë më datë 15.7.1999, bazuar në nenin 141 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në nenin 438 të Kodit të Procedurës Penale dhe në nenin 9 të ligjit nr.8362, datë 1.7.1999, ka vendosur tërheqjen e kësaj çështjeje nga Kolegji Penal dhe kalimin e saj për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara.

kolegjet e bashkuara të gjykatës së lartë

pasi dëgjuan relatin e Kryetarit Thimjo Kondi, Prokurorin e Përgjithshëm Arben Rakipi, që kërkoj pranimin e kërkesës për transferimin e çështjes për t'u gjykuar në shkallë të parë në gjykatën e Beratit që është kompetente nga pikëpamja tokësore, avokatin mbrojtës të të pandehurve Haki Kraja, që kërkoj vazhdimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Tiranës, e pasi e biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë:

Kërkesa e prokurorit për transferimin e çështjes nga gjykata e shkallës së parë e Rrethit Gjyqësor të Tiranës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor të Beratit, nuk gjen mbështetje në nenin 94 të Kodit të Procedurës Penale. Ky konkluzion mbështetet në argumentet e mëposhtëm:

Me vendimin nr. 36, datë 2.4.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është vendosur një herë transferimi i kësaj çështjeje nga gjykata e Beratit në atë të Tiranës, duke e bërë këtë të fundit kompetente jo vetëm nga ana lëndore, por edhe nga ana tokësore. Ky vendim parashtron shumë shkurt e në mënyrë të përgjithshme se “pjesëmarrësit në proces cenohen nga situatat dhe gjendja e krijuar (në Berat), të cilat dëmtojnë zhvillimin e procesit”, duke mos iu referuar ndonjë të dhënë që do të çonte në këtë konkluzion e duke mos dhënë ndonjë argument që do të përligjte transferimin e çështjes në Tiranë. Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se ky vendim nuk mund të priset apo ndryshohet, për arsyen e thjeshtë që ato nuk janë vënë në lëvizje për këtë qëllim, në rrugë procedurale të përligjura, të mundshme e të përshtatshme; d.m.th. bazueshmëria dhe ligjshmëria e tij nuk përbëjnë lëndë shqyrtimi për to (Kolegjet e Bashkuara). Shkurt, nisur nga premisa që vendimi i Kolegjit Penal që ka transferuar një herë çështjen në Tiranë është bërë i paatakueshëm, shumica mendon që objekt shqyrtimi është vetëm kërkesa e prokurorit për ritransferimin e çështjes në Gjykatën e Beratit. Në kuptim të nenit 94 të Kodit të Procedurës Penale, nuk rezulton, e as ngrihet një pretendim i tillë, që në Tiranë të ketë mungesë sigurie publike, ose ndonjë situatë lokale të tillë që të cenonte lirinë e vullnetit të personave që marrin pjesë në këtë proces. Ndonëse mund të pretendohet që vështirësohet sjellja e provave në Tiranë, sidomos ardhja aty e dëshmitarëve që janë me banim në Berat, kjo nuk është një arsye e përligjitur për ritransferimin e çështjes. Për më tepër, gjykimi i çështjes ka filluar në Tiranë dhe ritransferimi i saj do të ndikonte në zvarritjen e mëtejshme të saj dhe kalimin e afatit të gjykimit. Është e vërtetë që në disa raste të mëparshme Kolegji Penal ka bërë transferime e ritransferime çështjesh nga një gjykatë në tjetrën, duke iu referuar në mënyrë të përgjithshme nenit 94 të Kodit të Procedurës Penale, pa arsyetuar në çdo rast në se në rrethin përkatës mungon apo jo siguria publike, në se situata lokale është e rëndë dhe e tillë që cenon lirinë e vullnetit të personave që marrin pjesë në proces, në se mungesa e sigurisë publike dhe situatat e rënda lokale dëmtojnë zhvillimin e procesit dhe, së fundi, në se është e mundur apo jo që të gjitha këto rrethana negative të mënjanojnë me mënyra të tjera.

Për më tepër, në raste të tilla, nuk janë kërkuar dhe nuk janë administruar dokumentet dhe vërejtjet eventuale të gjykatës ku ka filluar gjykimi, të cilat duhet të shoqërojnë kërkesën për transferim. Në të gjitha rastet e mëparshme, kur është vendosur transferimi, zgjedhja e gjykatës kompetente nuk është bërë sipas kriterëve të nenit 76 të Kodit të Procedurës Penale, tek i cili të referon neni 94 i këtij Kodi.

Janë pikërisht disa nga këto praktika për transferimin e çështjeve penale dhe përcaktimin e gjykatës kompetente, ku do të transferohet çështja që kanë krijuar paqartësi e interpretime të ndryshme, deri kontradiktore, të cilat shtruan nevojën për dhënien e një vendimi unifikues.

Neni 94 i Kodit të Procedurës Penale jep kuadrin e përgjithshëm për shkaqet e transferimit të një çështjeje penale, por kërkesa për transferim nuk duhet të bëjë thjeshtë një referim tek kjo dispozitë. Kur ligjvënësi shprehet që kjo kërkesë duhet të jetë e motivuar, ai kërkon që, sipas rastit, prokurori apo i pandehuri, të japin argumentet përkatëse, të cilat të çojnë në përfundimin që situata e rëndë lokale e pretenduar dhe pasojat që mund të vijnë prej saj, i përshtaten kuadrit të përgjithshëm të kërkuar nga dispozita e mësipërme. Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna e fakte dhe përfundime lidhur me to. Është kjo arsyeja që në nenin 95/1 të Kodit të Procedurës Penale, kërkohet që asaj t'i bashkangjiten dokumentet që lidhen me të. Gjithashtu, në paragrafin e tretë të kësaj dispozite, krahas dokumenteve kërkohen edhe vërejtjet eventuale. Nuk del qartë se kush mund t'i bëjë këto vërejtje eventuale, por nisur nga fakti që, sipas paragrafit të parë, kërkesa e transferimit..., u njoftohet brenda 7 ditëve palëve të tjera, kuptohet që është fjala për to. Por vërejtje eventuale lidhur me domosdoshmërinë apo jo të transferimit të çështjes, krahas prokurorit apo të pandehurit (sipas rastit), mund të ketë edhe vetë gjykata, ku është regjistruar çështja apo ka filluar gjykimi.

Ligjvënësi, gjithashtu, nuk shprehet konkretisht se cilat janë të dhënat e nevojshme që merr në shqyrtim Gjakata e Lartë në dhomën e këshillimit (neni 97/1 i Kodit të Procedurës Penale). Duke i shqyrtuar në harmoni dispozitat e seksionit të VII të kreut të II të Kodit të Procedurës Penale (neni 94 deri 97) me të dhëna të nevojshme duhet të kuptojmë faktet dhe rrethanat që përmenden në dokumentet që shoqërojnë kërkesën për transferimin e çështjes. Nuk mund të jepen receta rreth tyre,

por, gjithsesi, ato duhet të jenë të tilla që të kenë vlerën e provës, d.m.th. të jenë marrë nga burime të ligjshme e në rrugë të ligjshme, të përmbajnë karakteristikat e një dokumenti zyrtar dhe të largojnë çdo dyshim rreth vërtetësisë së tyre. Duke qenë se organet e policisë janë përgjegjëse për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, kuptohet që u takon atyre të shprehen zyrtarisht e të informojnë gjykatën për situatën lokale të krijuar, në se kjo situatë është e rëndë, në se mund të dëmtojë zhvillimin e procesit gjyqësor të filluar dhe në se është e mundur që pasojat eventuale të dëmshme të mënjanoen në mënyra të tjera. Duke qenë se çështja shqyrtohet nga Kolegji Penal në dhomën e këshillimit dhe pa pjesëmarrjen e palëve, është e nevojshme që kërkesa, dokumentet që lidhen me të, si dhe vërejtjet eventuale, të jenë sa më të plota, të sakta e të argumentuara qartë. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm ka gjykata që procedon çështjen, d.m.th. gjykata kompetente ku ka filluar gjykimi. Ajo duhet të informojë hollësisht Gjykatën e Lartë për ecurinë e procesit, si dhe t'i parashtojë asaj konkluzionet e saj rreth bazueshmërisë së kërkesës për transferimin e çështjes. Pavarësisht nga kërkimet e palëve, që mund të jenë edhe subjektive, gjykata që ka filluar gjykimin është përgjegjëse për ecurinë normale të tij dhe për shmangien e tendencave për zvarritje të gjykimit. Është kjo arsyeja që neni 96 i Kodit të Procedurës Penale parashikon që paraqitja e kërkesës për transferim nuk ka efekt të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për pezullimin e gjykimit. Për më tepër, gjykata nuk ka të drejtë të pezullojë vetë gjykimin, por, pavarësisht nga kërkesa e paraqitur, është e detyruar ta vazhdojë atë, deri sa t'i mbrijë vendimi i pezullimit nga Gjykata e Lartë (në qoftë se merret një vendim i tillë). Gjithsesi, ashtu siç parashikon neni 96 i Kodit të Procedurës Penale, është e natyrshme që gjykata nuk mund të përfundojë çështjen deri sa të mos jetë vendosur për rrëzimin e kërkesës për transferim. Gjithashtu, edhe kur Gjykata e Lartë vendos pezullimin e gjykimit, pezullimi nuk pengon kryerjen e veprimeve të ngutshme (neni 96/2 i Kodit të Procedurës Penale). Ligjvënësi e ka pasur parasysh se, që nga koha e depozitimit të kërkesës për transferimin e çështjes, deri në mbritjen e vendimit të Gjykatës së Lartë që urdhëron pranimin ose jo të kësaj kërkesë, objektivisht kërkohet një kohë e caktuar, sado të përpigemi ta shkurtojmë atë. Megjithatë, nenet 95, 96 e 97 të Kodit të Procedurës Penale, i detyrojnë gjykatat të kryejnë veprime të shpejta për komunikimet dhe përcjelljen e materialeve të çështjes nga një gjykatë në një tjetër.

Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar saktësisht kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykimit të çështjes penale, kriteret për përcaktimin e tyre, si dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për kompetencat. Kompetenca lëndore dhe, sidomos, ajo tokësore duhet të mbahen parasysh edhe kur kërkohet e vendoset transferimi i çështjes. Jo më kot neni 94 i Kodit të Procedurës Penale të referon në nenin 76 të këtij Kodi, i cili përcakton rregullat e përgjithëshme të përcaktimit të kompetencës tokësore. Në rastet e vërejtura deri tani të transferimit të çështjeve, zor se gjen ndonjë referim tek neni 76 i Kodit të Procedurës Penale dhe aplikim të kërkesave të kësaj dispozite. Transferimet janë kërkuar dhe janë bërë në gjykatën e Rrethit të Tiranës, apo në ndonjë gjykatë të ndonjë rrethi të afërt me gjykatën ku ka filluar procedimi, pa iu referuar e pa zbatuar kriteret e nenit 76 të Kodit të Procedurës Penale, gjë që përbën shkelje të ligjit. I tillë është dhe rasti në shqyrtim, ku Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 36, datë 2.4.1999 shprehet thjeshtë: “ Çmohet se ka vend për transferimin e çështjes nga gjykata e rrethit Berat në gjykatën e Rrethit të Tiranës”.

Në kërkesën për transferim dhe veçanërisht në vendimin për transferimin e çështjes është e detyrueshme të merren parasysh dhe të zbatohen kriteret e nenit 76 të Kodit të Procedurës Penale, gjersa neni 94 referon vetëm tek kjo dispozitë dhe nuk përcakton vetë ndonjë kriter tjetër. Konkretisht, çështja mund të transferohet vetëm në gjykatën e vendit ku është kryer apo është tentuar të kryhet vepra penale, në gjykatën e vendit ku ka ardhur pasoja, në gjykatën e vendqendrimit ose të vendbanimit të të pandehurit ose në gjykatën e vendit ku ndodhet prokuroria që ka regjistruar e para veprën penale. Është e vërtetë që këto raste janë të kufizuara dhe aplikimi në praktikë vetëm i kriterëve të nenit 76 të Kodit të Procedurës Penale mund të paraqesë vështirësi, por, gjersa ligjvënësi nuk ka parashikuar kriteret të tjera dhe këto që përmenden në nenet 94 dhe 76 të Kodit të Procedurës Penale janë taksative dhe jo indikative, atëherë gjykatës nuk i lejohet të gjejë e të aplikojë kriteret të tjera e, për më tepër, të bëjë zgjidhje arbitrare që do të kënaqnin interesat subjektive të palëve në proces.

Kriteret e përcaktimit të gjykatës ku do të transferohet gjykimi i çështjes janë të kufizuara sepse edhe vetë veprimi procedural i transferimit nuk përbën rregull, por përjashtim. Si i tillë ai duhet të kryhet në raste tepër të ralla, sipas shkaqeve të parashikuara në mënyrë strikte në nenin 94 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 94 i Kodit të Procedurës Penal i referohet situatave të rënda lokale. Deri më sot në

legjislacion, doktrinë apo jurisprudencë, nuk kemi hasur ndonjë përkufizim apo shpjegim të termit “situatë e rëndë lokale”. Po t’i referohemi Kushtetutës, në nenet 170 - 176 të saj, përdoren termat “gjendje lufte”, “gjendje e jashtëzakonshme”, “gjendje fatkeqësie natyrore”, të cilat lejojnë vendosjen me ligj të masave të jashtëzakonshme. Duke pranuar që fjalët “situatë” dhe “gjendje” t’i konsiderojmë si sinonime, duhet të pranojmë gjithashtu se situatat që imponojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme për shkak që përcaktohen në Kushtetutë, janë të tilla që plotësojnë kuadrin objektiv të një situate të rëndë lokale në kuptim të nenit 94 të Kodit të Procedurës Penal. Megjithatë, në kuptim të dispozitës në fjalë, mund të kemi situata të rënda në një rreth apo zonë të caktuar e megjithatë nuk çmohet e domosdoshme të vendoset marrja e masave të jashtëzakonshme. Nga ana tjetër, mund të ndodhë që në një zonë apo pjesë të caktuar të territorit të vendosen me ligj masa të jashtëzakonshme për të përballuar gjendjen e rrezikut për rendin kushtetues e për sigurinë publike, apo për të parandaluar ose mënjeluar pasojat e një fatkeqësie natyrore ose të një aksidenti teknologjik e, megjithatë çmohet se nuk është e domosdoshme të transferohet gjykimi i çështjeve penale në gjykata të tjera. Si përfundim, tronditja e rendit dhe e sigurisë publike në një rreth të caktuar, pavarësisht, në se çmohet vendosja ose jo, me vendim të Kuvendit, e masave të jashtëzakonshme, në kuptim të nenit 94 të Kodit të Procedurës Penale, nuk përbën në vetvehte shkak absolut për transferim të gjykimit të çështjeve penale. Ndërsa kjo dispozite jep kuadrin e përgjithshëm të shkaqeve të transferimit, të pasojave të dëmshme që mund të vinë prej tyre dhe kriterin e pamundësisë objektive të mënjanimi të tyre, është detyrë e kërkuesit të argumentojë për çdo rast konkret, në bazë të këtyre shkaqeve e kriterëve të përgjithshëm, në se duhet të transferohet çështja dhe, në përfundim të gjykimit, është detyrë e gjykatës të çmojë rast pas rasti në se duhet të pranohet kërkesa. Çështja konkrete duhet të transferohet patjetër vetëm kur situata e rëndë lokale, e vlerësuar si e tillë nga gjykata, cenon lirinë e vullnetit të pjesëmarrësve në proces dhe kur forcat e rendit, në mënyrë të argumentuar e bindëse, nuk garantojnë mënjanimin e faktorëve të dëmshëm dhe ecurinë normale të procesit brenda kërkesave të Kushtetutës e të ligjit. Neni 94 i Kodit të Procedurës Penale nuk bën fjalë për një situatë të rëndë lokale në përgjithësi, por për atë situatë që cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë sigurinë publike ose lirinë e vullnetit të personave që marrin pjesë në proces e që, si të tilla, mund të dëmtojnë zhvillimin e procesit. Procesi gjyqësor quhet i dëmtuar në qoftë se ai nuk është në gjendje t’i garantojë të pandehurit dhe pjesëmarrësve të tjerë në proces liritë dhe të drejtat vetjake për një proces të rregullt ligjor, për një gjykim të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Në qoftë se pjesëmarrësit në proces dhe dëshmitarët, për shkak të situatave të krijuara, nuk kanë garanci për jetën dhe shëndetin e tyre dhe të familjarëve, nuk kanë garanci për ruajtjen e pronave të tyre etj., ose, në përgjithësi, ndihen të kërcënuar seriozisht e të frikësuar, atëherë nuk mund të zhvillohet një proces gjyqësor normal.

Krahas bindjes për mospasjen e garancive për siguri publike e vetjake të pjesëmarrësve në proces, gjykata duhet të krijojë bindje gjithashtu që kjo gjendje është e vazhdueshme dhe nuk mund të mënjanohej në mënyra të tjera, të paktën brenda një afati kohor të shkurtër, të tillë që do të linte kohë që gjykimi i filluar të përfundonte brenda afateve ligjore.

Natyrisht, për sa më lart nuk mund të jepen receta të përgjithshme, sepse çdo situatë ka veçoritë e saj specifike, por të gjitha këto duhet të shqyrtohen e të analizohen rast pas rasti e, mbi këtë bazë, të nxirren përfundime, duke u bazuar gjithmonë në kuadrin që parashikon neni 94 i Kodit të Procedurës Penal. Në çdo rast konkret mungesa e sigurisë së përgjithshme publike me ndikim të drejtpërdrejtë negativ e të pashmangshëm, nuk vlerësohet subjektivisht nga shkalla e marrjes së masave të sigurisë nga forcat e rendit, nga impenjimi i tyre për kryerjen e detyrave të ngarkuara me ligj, as nga impenjimi i gjykatës për përgatitjen e gjykimit dhe arritjen e standardeve të kërkuara për të. Transferimi i çështjes imponohet të bëhet vetëm kur siguria publike dhe zhvillimi normal i procesit cenohen, apo rrezikohen të cenohen, nga faktorë të jashtëm kriminalë të pashmangshëm. Ato nuk kanë të bëjnë me kërkesat normale për respektimin e rregullave nga gjykata dhe aktorët e procesit (akuza dhe mbrojtja), as me kërkesat e zakonshme për mbrojtjen e jetës, shëndetit e dinjitetit të gjyqtarit, prokurorit, avokatëve, dëshmitarëve etj. Në një kuptim të përgjithshëm, gjyqtarët e prokurorët, ndonjëherë edhe avokatët, për shkak të detyrës së tyre, eventualisht janë të kërcënuar e kanë nevojë të garantohen me masa të veçanta mbrojtjeje e sigurie. Edhe dëshmitarët e një procesi penal mund të ndihen të frikësuar apo të kërcënuar. Megjithatë, transferimi i çështjes, në pajtim me tërësinë e shkaqeve e kriterëve të nenit 94 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të vendoset vetëm kur këto rreziqe rezultojnë reale, iminente dhe të tilla që objektivisht nuk mund të mënjanohej në kohë me

forcimin e masave të rendit e të sigurisë. Në transferimin e çështjes nuk ka vend të udhëhiqemi nga arsye apo motive subjektive, personale etj. të këtij lloji.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 94 të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S Ë N:

Rrëzimin e kërkesës së prokurorit për transferimin e çështjes penale me të pandehur Musa Protoduari etj. nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Beratit.

MENDIMI I PAKICËS.

Bashkohemi me shumicën përsa i përket arsyetimit të vendimit për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore, lidhur me zbatimin e neneve 94 e vijues dhe 76 të Kodit të Procedurës Penale për shkaqet, kriteret dhe procedurën e transferimit të çështjes penale, si dhe për kriteret e përcaktimit të gjykatës kompetente, ku duhet të transferohet çështja.

Ndahemi me shumicën përsa i përket zgjidhjes së çështjes konkrete. Arsyetimin e shumicës, sipas të cilit bazueshmëria e ligjshmëria e vendimit të Kolegjit Penal nr. 36, datë 2.4.1999 nuk përbën lëndë shqyrtimi për Kolegjet e Bashkuara, nuk na duket i drejtë. Është e vërtetë që ky vendim i Kolegjit Penal është i formës së prerë dhe nuk ekziston ndonjë mjet ligjor për ta kundërshtuar atë në rrugë të drejtpërdrejtë në Kolegjet e Bashkuara. Megjithatë, ky vendim nuk është vendim që e zgjidh çështjen në themel e në mënyrë përfundimtare. Vendime të tilla, kur çështja është në proces, në çdo shkallë apo gjendje të gjykimit, janë të revokueshme prej instancës gjyqësore që i ka dhënë ose prej një instance më të lartë, kur ajo është vënë në lëvizje, për çfarëdo lloj shkak, qoftë edhe “incidentalisht”. Kjo bëhet kur çmohet se ka vend të bëhet një vlerësim i ndryshëm i fakteve dhe rrethanave të çështjes apo të rregullohet një gabim ligjor eventual, aq më tepër kur këto vlerësime e zgjidhje të gabuara janë evidente. Kolegji Penal, ashtu edhe Kolegjet e Bashkuara, në rastin konkret, duke e pasur çështjen në dorë, kanë të drejtë të bëjnë vlerësimet e tyre për aspekte të ndryshme të saj, në pikëpamje të faktit e të ligjit.

Për më tepër, në rastin konkret nuk mund të heshtet para faktit që vendimi nr. 36, datë 2.4.1999 i Kolegjit Penal është i paarsyetuar, gjë që bie ndesh me parimin e pranuar në nenin 142/1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, i cili kërkon që vendimet gjyqësore të jenë gjithmonë të arsyetuara. Si rrjedhim, qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara duhej të ishte dërgimi i çështjes për të vazhduar gjykimi në Gjykatën e Rrethit të Beratit, sepse kjo gjykatë është kompetente në pikëpamje lëndore e tokësore dhe se në kohën kur ka filluar gjykimi në Berat, ndryshe nga sa ka pranuar a priori Kolegji Penal në vendimin e sipërcituar, nuk janë vërtetuar shkaqet që kërkon neni 94 i Kodit të Procedurës Penale për transferimin e çështjes në një gjykatë tjetër. Për më tepër, edhe sikur të ishte provuar e kundërta, çështja në fjalë nuk ka asnjë element lidhës (kriter), në kuptim të nenit 76 të Kodit të Procedurës Penale, në bazë të të cilit do të konkludohej që edhe Gjykata e Tiranës, në mënyrë alternative, të mund të konsiderohej kompetente për gjykimin e saj. Do të ishte kontradiktore, madje paradoksale, që në një vendim, siç ndodh në rastin konkret në qëndrimin e mbajtur nga shumica, nga njëra anë të bëhen pohime e të arrihet në përfundime të caktuara teorike dhe në orientimet përkatëse për praktikën dhe, nga ana tjetër, të tolerohet një zgjidhje e mëparëshme që bie ndesh me këto pohime, konkluzione dhe orientime.

Si përfundim, zgjidhja e drejtë e çështjes do të ishte revokimi i shprehur i vendimit nr. 36, datë 2.4.1999 të Kolegjit Penal, ose anashkalimi i tij, duke konkluduar se ky vendim i prodhoi efektet e tij me transferimin e çështjes në Tiranë. (Në të dy rastet efektet praktike janë të njëjta). Në përfundim duhej të urdhërohej dërgimi i çështjes për të vazhduar gjykimi në gjykatën e rrethit të Beratit.

A N Ë T A R A N Ë T A R K R Y E S U E S
T. ZAKAV. METANI TH. KONDI

A N Ë T A R A N Ë T A R A N Ë T A R
A. HOXHA N. SHESHI A. LAMAJ

Tiranë, më 29.7.1999
Nr.263 i regjistrit themeltar